

Njoftim për plotësimin e formularit të aplikimit për në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL)

Njoftojmë të gjithë maurantët/kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në garën e pranimit në IAL, se duhet së pari të bëjnë plotësimin pranë shkollave përkatëse të mesatares në portalin matura.akp.gov.al. Mesatarja pasqyrohet në sistemin informatik nga përfaqësuesit e autorizuar të shkollave të mesme dhe vetëm pas kryerjes së kësaj procedure, mauranti/kandidati mund të bëjë plotësimin e formularit të aplikimit për në IAL në çdo mjedis ku ka akses interneti, sipas kalendarit të publikuar. Plotësimi i këtij formulari lidhet me përzgjedhjen e jo më shumë se 10 (dhjetë) programeve të studimit preferenciale midis atyre të ofruara nga Institucionet Publike dhe Private të Arsimit të Lartë për vitin akademik 2016 – 2017. Pas këtij procesi të kryer me sukses, mauranti/kandidati bëhet pjesë e garës për t'u shpallur fitues në programet e studimit që IAL-të ofrojnë. Procesi i hedhjes në sistemin informatik të notës mesatare (sipas VKM-së Nr. 407, dt.01.06.2016) fillon në shkollat e mesme **ditën e premte dt. 29.07.2016 ora 08.30**. Kujtojmë se çdo maurant kandidat për hedhjen në sistem të notës së tij mesatare duhet të kryejë sipas radhës veprimet e mëposhtme:

1. Së pari duhet të shkarkojë nga faqja e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP) www.akp.gov.al faturën për arkëtim tek linku **fatura për arkëtim për plotësimin e formularit për në IAL** dhe më pas ta printojë.
2. Me këtë faturë të printuar duhet të paraqitet pranë zyrave të Postës Shqiptare, apo secilit filial të bankave të nivelit të dytë për të kryer pagesën e tarifës përkatëse prej 2000 lekësh.
3. Pas kësaj duhet të paraqitet në drejtorinë e shkollës, në të cilën kanë bërë aplikimin e formularit A1, apo A1Z dhe të dorëzojë mandat pagesën.
4. Pas dorëzimit të mandat pagesës, punonjësi i autorizuar nga drejtoria e shkollës hedh në sistemin informatik notën mesatare të tij sipas formulës së përcaktuar me VKM.

Vëmë në dukje se maurantët që nuk ndjekin procedurën e mësipërme nuk kanë mundësi të aplikojnë me formularin e aplikimit për në IAL për shkak të mungesës në sistem të notës mesatare.

Afati i plotësimit të notave mesatare në sistem është nga data 29.07.2016 ora 08.30 deri 10.08.2015, ora 16.30.

Gjithashtu aplikantët për në IAL, përsa i përket afateve të plotësimit të mesatares duhet të kenë parasysh edhe kalendarin e aplikimeve sipas Dar/Za-ve të publikuar në faqen tonë zyrtare. P.sh. maurantët dhe kandidatët e Dar Tiranë kanë si afat plotësimi të mesatares periudhën 29 korrik deri më 3 gusht 2016, meqënëse kjo është edhe data e fundit e aplikimit për maurantët/kandidatët në këtë DAR. Po njësoj për secilin Dar/Za afati i fillimit të plotësimit të mesatares në sistem është data 29 korrik dhe afati i fundit është ajo datë kur kanë të planifikuar ditën e fundit të aplikimit për në IAL.

Agjencia Kombëtare e Provimeve